



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3280 Prot.

Roskovec, më 30, 04 2021

V E N D I M

Nr. 30, datë 29/04/2021

**"PËR MIRATIM DHE TRANSFERIM FONDESH NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR
VITIN 2021"**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 23, të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjen vendore" neni 45, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" i ndryshuar neni 44, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë, të VKB nr.89 datë 02.12.2020 "Për miratimin e buxhetit, numrin maksimal të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe ndërmarjeve vartëse si dhe nivelin maksimal të pagave për vitin 2021", të kontratës së lidhur ndërmjet Bashkisë Roskovec dhe Këshillit të Europës datë 09.02.2021 për projektin "Promovimi i diversitetit dhe barazisë për komunitetin Rom dhe Egjiptian në Roskovec" si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Rregullimit të Territorit dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Shëndetësisë, Projekteve Sociale dhe Kordinimit me BE-në; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

I. Miratimin e fondit prej **10,469,928 lekë** për objektin : "Adaptimi i objektit të ish-tualetëve në kopësht dhe cerdhe".

Financimi nga fondi I Bashkisë Roskovec, i cili të përballohet :

- 2,000,000 lekë nga fondi për objektin "Blerjen e një mjeti vetëshkarkues" për vitin 2021.
- 8,469,928 lekë nga të ardhurat e bashkisë për vitin 2022.

Shtohet:

1. NJESIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe shtohet	2021	2022
1	00	09120	5	231	"Adaptimi i objektit të ish-tualetëve në kopësht dhe cerdhe"	10,469,928	2,000,000	8,469,928
					SHUMA:	10,469,928	2,000,000	8,469,928



Pakësohet:

1. NJESIA SHPENZUESE "BASHKIA ROSKOVEC", KODI 2113001

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe pakesohet	2021	2022
1.	00	04520	5	231	Blerjen e nje mjete vetëshkarkues	2,000,000	2,000,000	0
					SHUMA:	2,000,000	2,000,000	0

II. Miratimin e fondit shtesë në të ardhurat e bashkisë për vitin 2021, Grante nga Këshilli i Europës prej **1,199,390 lekë** për projektin “Promovimi i diversitetit dhe barazisë për komunitetin Rom dhe Egjiptian në Roskovec”.

Bazuar në kontratën e lidhur ky fond do të përdoret për shpenzime si më poshtë:

- Shpenzime Operative dhe mirëmbajtjes për projektin e mësipërm (art.602), 848,114 lekë.
- Blerje pajisje kompjuterike (art.231), 351,276 lekë.

Shtohet shpenzimet në buxhetin e bashkisë për vitin 2021, Njësia Shpenzuese “Bashkia Roskovec”, kodi 2113001:

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMËRTIMI I OBJEKTIT/SHPENZIMIT	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe shtohet	2021	2022
1	00	01110	5	602	Shpenzime operative dhe mirëmbajtjes	848,114	848,114	0
2	00	01110	5	231	Blerje pajisje kompjuterike	351,276	351,276	0
					SHUMA:	1,199,390	1,199,390	0

III. Ngarkohet Nëpunësi Autorizues dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

